

AMENDAMENTE PËR ADMINISTRATËN ZGJEDHORE

Shënim i rëndësishëm:

1. Pranimi i kësaj skeme të administratës zgjedhore passjell modifikime të tjera të kapitullit të administrimit dhe të procedurave, të cilat janë të nevojshme për shkak të terminologjisë.
2. Kjo skemë kërkon modifikime në kuadrin ligjor për nëpunësin civil, lidhur me rekrutimin, karrierën dhe disiplinën, për të lidhur performancën në shërbim të zgjedhjeve me rekrutimin dhe karrierën në shërbimin civil.
3. Kjo skemë kërkon që partitë politike ta ruajnë besimin ndaj menaxhimit të zgjedhjeve, jo më nëpërmjet pjesëmarrjes në administrim, por nëpërmjet **rritjes së mundësive dhe hapësirës për vëzhgim, forcimit të të drejtave garancive proceduriale për subjektet zgjedhore, si dhe nëpërmjet të drejtës për kontroll a posteriori të dokumentacionit të votimit.**
4. Kjo skemë kërkon modifikim të kapitullit për procedurat e votimit, numërimit, tabulimit të rezultatit, etj.
5. Amendamentet duhet të plotësohen edhe me dispozitën tranzitore që rregullon mandatin e anëtarëve aktualë të KQZ-së.

Amendament neni 12:

Neni

Neni 12 ndryshohet si vijon:

“Neni 12

Përbërja e KQZ-së

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga:
 - i. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
 - ii. Komisioni Rregullator; dhe
 - iii. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (*Komisioneri*) është organ monokratik që ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët.
3. Komisioni Rregullator (*Rregullatori*) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Rregullatori e ushtron veprimtarinë në mbledhje publike, të cilat thirren nga Komisioneri. Për pjesëmarrjen në mbledhje, anëtarët e Rregullatorit përfitojnë shpërblim në masën 50 për qind të pagës mujore të Komisionerit.

4. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) është organ kompetent për shqyrtimin e ankimimeve të subjekteve zgjedhore dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të Kodit Zgjedhor. KAS-i e ushtron veprimtarinë në seanca publike të shqyrtimit administrativ, të cilat thirren nga Komisioneri, me pjesëmarrjen e palëve të interesuara. Për veprimtarinë e tyre gjatë periudhës, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin, zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore ose zgjedhje të pjesshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, anëtarët e KAS-it përfitojnë shpërblim të barabartë me shumën e pesë pagave mujore të Komisionerit. Për veprimtarinë që zhvillojnë jashtë kësaj periudhe, anëtarët e KAS-it përfitojnë shpërblim në masën 50 për qind të pagës mujore të Komisionerit.”

Amendament neni 13:

Neni

Neni 13 ndryshohet si vijon:

“Neni 13

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

1. Komisioneri zgjidhet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për një mandat 7-vjeçar, të përtëritshëm.
2. Kanë të drejtën të kandidojnë ose të propozohen për komisioner, shtetasit shqiptarë që vijnë nga radhët e ish funksionarëve politikë, ish nëpunësve të nivelit të lartë drejtues, ose të ish drejtuesve të organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të të drejtave të njeriut.
3. Përzgjedhja e Komisionerit bëhet në bazë të eksperiencës së mëparshme të suksesshme në drejtim, të ligjëshmërisë së demonstruar ose të provuar në ushtrimin e detyrave apo funksioneve dhe të reputacionit publik të kandidatit.
4. Personi që kandidon ose që propozohet për komisioner nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen, nëse në momentin e kandidimit ka qenë në ushtrim të detyrës si funksionar politik, nëpunës i nivelit të lartë drejtues, apo drejtues i organizatës jofitimprurëse, ose kur komisioni kompetent i Kuvendit krijon bindjen se marrëdhënien e tij të punës e ka ndërprerë për shkak të kandidimit ose propozimit për komisioner.
5. Personi që kandidon ose që propozohet për komisioner nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen nga Kuvendi, nëse është anëtar aktiv i ndonjë partie politike, ose nëse ka interesa private, të dukshme ose të njohura, plotësimi i të cilave varet nga qeverisja në nivel qendror ose vendor.
6. Paga dhe privilegjet e Komisionerit janë të njëjta me pagën dhe privilegjet e kryetarit të Gjykatës së Lartë.”

Amendament neni 14:

Neni

Neni 14 ndryshohet si vijon:

“Neni 14

Komisioni Rregullator (Rregullatori)

1. Rregullatori përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për një mandat 5-vjeçar, sipas procedurës së përcaktuar në këtë Kod.
2. Kandidati për anëtar i Rregullatorit duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret për të qenë komisioner. Kriteri i eksperiencës profesionale në drejtim zëvendësohet për kandidatin për anëtar të Rregullatorit me kriterin e eksperiencës profesionale në hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e akteve ligjore.”

Amendament neni 15:

Neni

Neni 15 ndryshohet si vijon:

“Neni 15

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS)

1. KAS-i përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për një mandat 9-vjeçar, sipas procedurës së përcaktuar në këtë Kod.
2. Kanë të drejtë të kandidojnë ose të propozohen për anëtar të KAS-it, shtetasit shqiptarë që vijnë nga rradhët e ish gjyqtarëve, ish anëtarëve të KQZ-së, ose të ish nëpunësve të nivelit të lartë drejtues.
3. Përzgjedhja e anëtarit të KAS-it bëhet në bazë të eksperiencës së mëparshme të suksesshme, të ligjshmërisë së demonstruar ose të provuar në ushtrimin e detyrave apo funksioneve dhe të reputacionit publik të kandidatit.
4. Personi që kandidon ose që propozohet për anëtar të KAS-it nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen, nëse në momentin e kandidimit ka qenë në ushtrim të funksioneve si gjyqtar, anëtar i KQZ-së ose nëpunës i nivelit të lartë drejtues, ose kur komisioni përgjegjës i Kuvendit krijon bindjen se marrëdhënien e tij të punës e ka ndërprerë për shkak të kandidimit ose propozimit për komisioner.
5. Personi që kandidon ose që propozohet për anëtar të KAS-it nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen nga Kuvendi, nëse është anëtar aktiv i ndonjë partie politike, ose nëse ka interesa të dukshme ose të njohura, plotësimi i të cilave varet nga qeverisja në nivel qendror ose vendor.”

Amendament neni 16:

Neni

Neni 16 ndryshohet si vijon:

“Neni 16

Zgjedhja e Komisionerit, anëtarëve të Rregullatorit dhe të KAS-it

1. Komisioneri, anëtarët e Rregullatorit dhe anëtarët e KAS-it zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me jo më pak se tre të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
2. *Paraqitja e kandidaturave dhe shqyrtimi nga komisionet e Kuvendit dhe Kuvendi ne seancë plenare do të paraqitet në një mbledhje tjetër të Komisionit të Posacëm Zgjedhor.*
3. Në rast se Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Komisionerin, apo anëtarë të caktuar të Rregullatorit ose të KAS-it, me shumicën e kërkuar të votive sipas paragrafit të parë të këtij neni, atëherë administrata e Kuvendit hedh short midis të gjitha kandidaturave të paraqitura për votim Kuvendit për vendin përkatës. Fituesi i njoftohet Kuvendit dhe shpallet i zgjedhur në seance plenare nga Kryetari i Kuvendit.”

Amendament neni 17:

Neni

Neni 17 ndryshohet si vijon:

“Neni 17

Shkarkimi i Komisionerit, anëtarëve të Rregullatorit dhe të KAS-it

1. Shkarkimi i Komisionerit, anëtarëve të Rregullatorit dhe të KAS-it bëhet vetëm për të njejtat shkaqe (*kushte dhe kritere*), për të cilat nuk do të lejohej zgjedhja e tyre në detyrën përkatëse. Shkaqet për shkarkim duhet të kenë ndodhur pas fillimit të detyrës dhe duhet të jenë vërtetuar nga organet shtetërore që kanë kompetencë vërtetimin e tyre.
2. Në procedurën e shkarkimit, komisioni përgjegjës i Kuvendit nuk mund të bëjë vërtetimin e shkaqeve, por vetëm administrimin e dokumentave zyrtare të formës së prerë që vërtetojnë ekzistencën e shkaqeve për shkarkim.
3. Procedura e shkarkimit kryhet sipas dispozitave të Rregullores së Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të organeve të krijuara me ligj, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë nen.
4. Komisioneri, anëtarët e Rregullatorit dhe anëtarët e KAS-it shkarkohen, kur “pro” shkarkimit votojnë jo më pak se tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.”

Amendament neni 18:

Neni

Neni 18 ndryshohet si vijon:

“Neni 18

Kompetencat e Komisionerit

Komisioneri ka këto kompetenca:

- a) drejton institucionin dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët;
- b) drejton dhe mbikëqyr, drejtpërdrejt ose nëpërmjet administratës së KQZ-së, veprimtarinë e administratës zgjedhore përgjatë zgjedhjeve;
- c) vë në lëvizje Rregullatorin dhe KAS-in, sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tyre, u përgatit mbledhjet dhe seancat, si dhe kujdeset për zbardhjen dhe publikimin e akteve. Komisioneri nuk mund të vendosë për çështje që janë kompetencë e Rregullatorit apo KAS-it;
- d) emëron dhe shkarkon zyrtarët zgjedhorë;
- e) lidh, në emër të KQZ-së, marrëveshje dhe kontrata me të tretët dhe monitoron ose kontrollon zbatimin e tyre;
- f) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- g) organizon dhe administron proceset zgjedhore të institucioneve dhe organizmave publike, kur ligji e ngarkon me këtë detyrë;
- h) monitoron, nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara, fushatën zgjedhore, shpenzimet e subjekteve zgjedhore, si dhe pasqyrimin e fushatës në media;
- i) monitoron, nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara, sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimit të burimeve publike;
- j) kujdeset për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve;
- k) drejton procesin e trainimit dhe kualifikimit të administratës zgjedhore;
- l) informon publikun për veprimtarinë e KQZ-së, për vendimmarrjen, për fushatën, procesin e votimit dhe rezultatin e zgjedhjeve;
- m) prodhon dhe publikon të dhëna statistikore për zgjedhjet në vite, të dhëna statistikore për raportet gjinore në zgjedhje, administrimin e tyre, në kandidim dhe në organet e zgjedhura, si dhe të dhënat për listat e kandidatëve të Kuvendit dhe të organeve të qeverisjes vendore;
- n) administron buxhetin e KQZ-së, sipas rregullave të fushës;
- o) përgatit projektbuxhetin vjetor dhe atë për zgjedhjet, sipas ligjit përkatës, si dhe, pas miratimit me ligj të buxhetit, përcakton strukturën e shpenzimeve buxhetore.
- p) raporton përpara Kuvendit për veprimtarinë e institucionit;

- q) përgatit dhe i përcjell për miratim Kuvendit strukturën, organikën dhe strukturën e pagave të administratës së KQZ-së, me kohë të plotë pune dhe asaj me kohë jo të plotë;
- r) kujdeset për zbatimin nga KQZ-ja të detyrave të ngarkuara me ligje të veçanta.”

Amendament neni 19:

Neni

Neni 19 ndryshohet si vijon:

“Neni 19

Kompetencat e Rregullatorit

1. Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për:
 - a) rregullat dhe procedurat nënligjore të zgjedhjeve;
 - b) rregullat dhe udhëzimet për njehsimin dhe përmirësimin e praktikave zgjedhore;
 - c) rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara përgjatë fushatës, si dhe procedurën e KQZ-së për zbatimin e ndalimit;
 - d) rregullat për metodologjinë e monitorimit të medias, për procedurën e shqyrtimit të raporteve dhe për vendosjen e masave qortuese apo ndëshkimore;
 - e) rregulloren e mbledhjeve të Rregullatorit dhe rregulloren e seancave të KAS-it;
 - f) rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin;
 - g) llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë;
 - h) rregullat për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qendrueshëm të tyre;
 - i) rregullat për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, monitorimin dhe auditimin e pavarur të tyre, si dhe për hetimin administrativ të informacioneve kërkesave, propozimeve, ankesave apo denoncimeve për shkelje lidhur me financimin apo shpenzimet e fushatës;
 - j) udhëzuesit dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve;
 - k) tarifatat e shërbimit për organizimin dhe administrimin e proceseve zgjedhore të institucioneve dhe organizmave publike, kur ligji e ngarkon me këtë detyrë;
2. Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së për:
 - a) kufijtë e zonave të administrimit zgjedhor, në përputhje me këtë ligj;

- b) numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet në Kuvend;
- c) përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte apo procedura të vecanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi;
- d) zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundesojnë votimin;
- e) rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi, në përputhje me këtë ligj.”

Amendament neni 20:

Neni

Neni 20 ndryshohet si vijon:

“Neni 20

Kompetencat e KAS-it

Në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, KAS-i ushtron këto kompetenca:

- a) vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve, në një ose më shumë qendra votimi, në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe për përsëritjen e pjeshme ose të plotë të zgjedhjeve;
- b) shqyrton dhe zgjidh ankesat e subjekteve zgjedhore për zhvillimin e procesit zgjedhor;
- c) vendos sanksione administrative kundër personave apo subjekteve, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet;
- d) vlerëson performancën e zyrtarëve zgjedhorë, për çështjet që shqyrton.”

Amendament neni 21:

Neni

Neni 21 ndryshohet si vijon:

“Neni 21

Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje

1. KQZ-ja ka të drejtë të eksplorojë, eksperimentojë dhe të vendosë përdorimin në zgjedhje të sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit, për të mbuluar aspekte dhe/ose procedura të vecanta të procesit zgjedhor, si dhe ka të drejtë të prokurojë sisteme apo pajisje të teknologjisë së informacionit apo edhe shërbimin e operimit të tyre. KQZ është e detyruar që përdorimin e sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë informacionit ta zbatojë në zgjedhje nëpërmjet projekteve pilot, në jo më pak se 20 përqind të numrit të zgjedhësve për çdo fazë të implementimit.
2. Përdorimi i sistemeve ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit bëhet në përputhje me rregullat e posaçme lidhur me procedurat për aspektet e veçanta të procesit që mbulohen nga

sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit. Rregullat procedurale për këtë qëllim miratohen me akt normativ të KQZ-së.

3. Sistemet ose pajisjet e teknologjisë së informacionit që KQZ-ja vendos të përdoren në zgjedhje duhet të synojnë, në radhë të parë, identifikimin biometrik të votuesve, votimin me dhe nëpërmjet pajisjeve elektronike, si dhe numërimin nga pajisjet të votave të hedhura.
4. Identifikimi, përzgjedhja dhe përdorimi i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit i nënshtrohen parimeve të ligjshmërisë, transparencës, gjithëpërfshirjes, sigurisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë.
5. Përpara çdo procesi zgjedhor, sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit duhet t'i nënshtrohen testimit operacional nga KQZ-ja, në seanca publike dhe me procedurë të saktë dhe të detajuar, duke përzgjedhur, me kriter rastësor për secilën zonë zgjedhore, jo më pak se tri për qind të pajisjeve që do përdoren dhe duke simuluar me to veprimet operationale zgjedhore, për një numër jo më të vogël se 50 votues.
6. Pas çdo procesi zgjedhor, pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe konstituimit të organeve të zgjedhura, KQZ-ja kryen, në seanca publike dhe me procedurë të detajuar verifikimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informatike që janë përdorur për votimin dhe numërimin e votave në zgjedhje, nëpërmjet numërimit manual të jo më pak se 10 për qind të qendrave të votimit. Qendrat e votimit përzgjidhen nga KQZ-ja me kriter rastësor për secilën zonë zgjedhore, dhe krahasimit të rezultatit me rezultatin e nxjerrë nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit.
7. Rezultatet e testimit parazgjedhor dhe të verifikimit paszgjedhor të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit kushtëzojnë vendimmarrjen e KQZ-së për përdorimin në vijim të teknologjisë. Ato nuk mund të jenë bazë në vetvete, dhe as nuk mund të shërbejnë qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, për ankimimin, kundërshtimin, mosnjohjen e rezultatit të zgjedhjeve, apo për anulimin, heqjen, shfuqizimin apo ndërprerjen e mandatit të fituar nga zgjedhjet, për cilindo subjekt, person të interesuar apo institucion që kërkon të ndërmarrë hapa ligjore në këtë drejtim. Rezultatet e testimit parazgjedhor dhe të verifikimit paszgjedhor mund të bëhen objekt i hetimit për kryerje të veprës penale nëse nxjerrin të dhëna dhe krijojnë dyshime për kryerjen e veprave penale, nëpërmjet keqpërdorimit të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit në zgjedhje.”

Amendament neni 21/1:

Neni

Neni 21/1 ndryshohet si vijon:

“Neni 21/1

Procedura për futjen e teknologjisë në zgjedhje dhe vendimmarrja

1. Sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit në zgjedhje vihen në përdorim nga personel i kualifikuar i KQZ-së, i punësuar për këtë qëllim, përveçse kur KQZ-ja vendos që përdorimi i tyre të bëhet nga operatorë privatë të kontraktuar sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin e shërbimeve. Prokurimi i shërbimit mund të jetë pjesë e kontratës për prokurimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe mund të kryhet edhe nga furnizuesi i këtyre të fundit.
2. Përdorimi i sistemeve ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit kryhet në përputhje me rregulloren teknike të përdorimit, e cila, përveç rregullave që burojnë nga manuali i përdorimit, duhet të përfshijë rregullat për testimin parazgjedhor, për dokumentimin e procedurave operacionale, për konstatimin dhe raportimin e defekteve, shkeljeve apo dhunimeve gjatë operimit, për pezullimin e operacioneve me dhe nëpërmjet sistemeve apo pajisjeve dhe kryerjen e procedurave manualisht, si dhe për përmbylljen e veprimeve operacionale me dhe nëpërmjet sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe raportimin e rezultateve. Rregullorja teknike e përdorimit të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informatike miratohet me akt normativ të KQZ-së.
3. Në rastet kur nga testimi parazgjedhor rezulton se sistemet apo pajisjet shfaqin defekte apo pasaktësi operacionale, të cilat mund të cenojnë integritetin e tyre apo të procedurave, atëherë KQZ-ja mund të vendosë zbatimin e procedurave manualisht dhe të heqë sistemet apo pajisjet nga përdorimi në zgjedhjet e radhës.”

Amendament neni 21/2:

Neni

Neni 21/2 ndryshohet si vijon:

“Neni 21/2

Kompetencat e KQZ-së lidhur me votimin nga jashtë vendit

1. KQZ-ja udhëheq dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit dhe kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë.
2. Votimi nga jashtë shtetit organizohet dhe administrohet nga KQZ-ja në të gjithë komponentët e tij, pasi Rregullatori të ketë miratuar të gjitha aktet nënligjore që kërkohen për votimin nga jashtë vendit, sipas këtij Kodi.
3. KQZ-ja duhet të marrë vendim për përfshirjen për herë të parë të votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit. Në zgjedhjet vijuese, votimi nga jashtë vendit bëhet automatikisht pjesë përbërëse e procedurave të votimit.
4. Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me akt normativ të KQZ-së.”

Amendament neni 22:

Neni

Neni 22 ndryshohet si vijon:

“Neni 22

Procedura e votimit nga jashtë vendit

1. Pavarësisht nga procedura e votimit, manuale ose elektronike, votat e votuesve nga jashtë vendit administrohen nga KQZ-ja, duke garantuar integritetin e votimit dhe fshehtësinë e votës, nga çdo ndërhyrje mbi fletët e votimit ose mbi informacionin elektronik të votimit që administrohet prej saj.
2. Votimi nga jashtë vendit quhet i çelur nga dita që KQZ-ja nis procedurat për dërgimin e dokumentacionit të votimit ose, sipas rastit, dokumentacionit udhëzues në adresë të zgjedhësve nga jashtë vendit. Votimi nga jashtë vendit mbyllet në ditën e votimit, në orën e caktuar nga ky ligj për mbylljen e votimit në qendrat e votimit. Me mbylljen e votimit nga jashtë vendit, KQZ-ja nuk mund të pranojë dhe përfshijë më në numërim asnjë fletë votimi të mbërritur më pas. Nëse votimi nga jashtë vendit bëhet elektronik, sistemi elektronik i votimit mbyllet në orën e caktuar nga ky ligj për mbylljen e votimit në qendrat e votimit.
3. Rregullat për administrimin e materialit zgjedhor ose të informacionit të votimit, të regjistruar dhe ruajtur nga sistemet e teknologjisë informatike, për votimin nga jashtë vendit, si dhe për testimin parazgjedhor dhe verifikimin paszgjedhor të sistemeve, janë pjesë e rregullave të përgjithshme që KQZ-ja miraton për administrimin e materialit zgjedhor apo për përdorimin e sistemeve të teknologjisë informatike në zgjedhje. Garancitë ligjore për vëzhgimin, monitorimin dhe aksesin në KQZ gjatë administrimit të votave nga jashtë vendit, si dhe për testimin, verifikimin dhe sigurinë e materiali zgjedhor apo të sistemeve të teknologjisë informative që përdoren për këtë votim nuk mund të jenë më të ulta se sa ato për votimin brenda vendit.”

Amendament neni 23:

Neni

Neni 23 ndryshohet si vijon:

“Neni 23

Programi i trajnimit

1. KQZ-ja zhvillon në mënyrë të rregullt programe trainimi për shtetasit me të drejtë vote, për kualifikimin e tyre në ushtrimin e detyrës si zyrtarë zgjedhorë.
2. Shtetasit me të drejtë vote pranohen në programet e trainimit kur gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ose plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
 - b) të jenë në kushte shëndetësore që i lejojnë të kryejnë detyrën;
 - c) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - ç) ndaj tyre të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit “Për nëpunësin civil”;
 - d) të kenë mbaruar arsimin e lartë, ose të jenë të paktën në vitin e fundit të studimeve të ciklit të parë “*bachelor*”.
3. Programet e trainimit si zyrtarë zgjedhorë për nëpunësit civilë janë pjesë e kurrikulës së Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), janë të detyrueshme për të gjitha nivelet e nëpunësve, organizohen në bashkëpunim me KQZ-në dhe drejtohen nga struktura e KQZ-së e ngarkuar me trainimin e zyrtarëve zgjedhorë. Për gjithë shtetasit me të drejtë vote që nuk janë pjesë e shërbimit civil, pranimi në programet e trainimit bëhet pas aplikimit individual nga shtetasit që plotësojnë kushtet për pranim. Për këta shtetas programet e trainimit organizohen nga KQZ-ja dhe zhvillohen nga struktura e saj e ngarkuar me trainimin e zyrtarëve zgjedhorë.
 4. Nuk mund të aplikojnë për t’u pranuar në programet e trainimit si zyrtarë zgjedhorë ushtarakët, punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror apo zyrtarë të tjerë që e kanë të ndaluar me ligj një gjë të tillë.
 5. Pjesëmarrësit, kur përfundojnë me sukses trainimin si zyrtarë zgjedhorë, pajisen nga KQZ-ja me dëshminë e zyrtarit zgjedhor dhe qartësohen si administratorë zgjedhorë.”

Amendament neni 24:

Neni

Neni 24 ndryshohet si vijon:

“Neni 24

Baza e të dhënave të zyrtarëve zgjedhorë

1. KQZ-ja mban dhe përditëson bazën e të dhënave të zyrtarëve zgjedhorë, e cila, përveç të dhënave identifikuese, përmban të dhëna të detajuara për moshën, gjininë, adresën e banimit, të vendit të punës dhe mënyrën e kontaktit, si dhe të dhëna të detajuara për kurset dhe ecurinë e trainimeve për secilin prej tyre, historikun e angazhimit në proceset zgjedhore, detyrat e kryera dhe ecurinë në ushtrimin e tyre.
2. Baza e të dhënave e zyrtarëve zgjedhorë përqaset përpara çdo zgjedhjeje me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Të dhënat për shtetësinë dhe adresën e vendbanimit korrigjohen në përputhje me të dhënat e regjistrit kombëtar të gjendjes civile.
3. Nga baza e të dhënave të zyrtarëve zgjedhorë nxirret, përpara çdo procesi zgjedhor, lista e zyrtarëve zgjedhorë. Lista formohet me të dhënat identifikuese të zyrtarëve zgjedhorë të

qartësuar si administratorë dhe shërben për të kryer përzgjedhjen e zyrtarëve zgjedhorë që do të administrojnë procesin.”

Amendament neni 25:

Neni

Neni 25 ndryshohet si vijon:

“Neni 25

Procedura e vlerësimit të performances

1. KQZ është organi që ka kompetencën për vlerësimin e performancës së zyrtarëve zgjedhorë.
2. Në vlerësimin e performancës përfshihen:
 - a) zyrtarët zgjedhorë, performanca e të cilëve është objekt i ankesave zgjedhore për pavlefshmëri të zgjedhjeve, ose për parregullsi të procesit të administrimit, numërimit dhe tabulimit të rezultatit të zgjedhjeve.
 - b) zyrtarët zgjedhorë, në veprimtarinë e të cilëve janë konstatuar shkelje ose parregullsi gjatë kryerjes së procedurave të kontrollit *a posteriori* të materialit zgjedhor, sipas këtij ligji, pavarësisht nga lloji i procedurës që kryhet dhe pavarësisht nëse shqyrtimi administrativ ka nisur për ta, apo jo.
3. Vlerësimi i performancës bëhet përpara përmbylljes së procedurave të KQZ-së për zgjedhjet e radhës.
4. Zyrtarët zgjedhorë marrin tri lloj vlerësimesh: vlerësimin “në rregull”, “me mangësi” dhe “pamjaftueshëm”.
5. Kur zyrtarët zgjedhorë vlerësohen “pamjaftueshëm”, atëherë ata nuk qartësohen për zgjedhjet e ardhshme dhe u hiqet dëshmia e zyrtarit zgjedhor.
6. Kur zyrtarët zgjedhorë vlerësohen “me mangësi”, atëherë ata i nënshtrohen trainimeve vazhduese. Deri në përfundimin me sukses të trainimit ata nuk qartësohen për zgjedhjet e ardhshme. Nëse nuk kualifikohen në trainimin vazhdues, atëherë emri i tyre fshihet nga lista e zyrtarëve zgjedhorë dhe u hiqet dëshmia e zyrtarit zgjedhor.
7. Të gjithë zyrtarët zgjedhorë që nuk bëjnë pjesë në kategoritë sipas shkronjave “a” dhe “b” të paragrafit 2 të këtij neni marrin automatikisht vlerësimin “në rregull” dhe qartësohen për zgjedhjet e ardhshme.”

Amendament neni 25/1:

Neni

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me përmbajtjen si vijon:

“Neni 25/1

Pasojat juridike të heqjes së dëshmisë

1. Zyrtarët zgjedhorë me statusin e nëpunësit civil, të cilëve u hiqet dëshmia e zyrtarit zgjedhor, u nënshtrohen edhe procedurave të shkarkimit si nëpunës civilë, në përputhje me ligjin “Për nëpunësin civil”.
2. Asnjë zyrtar zgjedhor, të cilit i është hequr dëshmia e zyrtarit zgjedhor, nuk mund të rifutet në listën e zyrtarëve zgjedhorë, pa kaluar gjashtë vjet nga data e shkarkimit. Rifutja në listë, pas kalimit të këtij afati, bëhet vetëm nëse zyrtari kryen rishtazi programet e trainimit dhe ripajiset me dëshminë e zyrtarit zgjedhor.”

Amendament neni 25/2:

Neni

Pas nenit 25/1 shtohet neni 25/2 me përmbajtjen si vijon:

“Neni 25/2

Qartësimi i zyrtarëve zgjedhorë

1. KQZ-ja kryen përpara çdo procedure emërimi të zyrtarëve zgjedhorë qartësimin e tyre si administratorë.
2. Qartësimi i zyrtarëve zgjedhorë përfshin, sipas rastit, veprimet e mëposhtme:
 - a) futjen në listën e zyrtarëve zgjedhorë të pjesmarrësve të kualifikuar në kurset e trainimit;
 - b) konfirmimin në listë të zyrtarëve zgjedhorë që janë vlerësuar “në rregull”;
 - c) konfirmimin në listë të zyrtarëve zgjedhorë që janë kualifikuar në kurset vazhduese, pas vlerësimit “me mangësi”;
 - ç) heqjen nga lista të zyrtarëve zgjedhorë që nuk janë kualifikuar në trainimet vazhduese, pas vlerësimit “me mangësi”;
 - d) heqjen nga lista të zyrtarëve zgjedhorë, për të cilët KQZ-ja ka marrë vendimin për shkarkimin nga detyra e zyrtarit zgjedhor;
 - dh) heqjen nga lista të zyrtarëve zgjedhorë, performanca e të cilëve është vlerësuar “pamjaftueshëm”;
 - e) heqjen nga lista të zyrtarëve zgjedhorë, të cilët ndërkohë janë punësuar ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror apo struktura të tjera shtetërore që e kanë të ndaluar me ligj qënien si zyrtarë zgjedhorë;
 - ë) heqjen përfundimtare nga lista të zyrtarëve zgjedhorë që në ditën e zgjedhjeve kanë mbushur ose mbushin moshën zyrtare të pensionit;”

Amendament neni 25/3:

Neni

Pas nenit 25/2 shtohet neni 25/3 me përmbajtjen si vijon:

“Neni 25/3

Procedura e përzgjedhjes dhe emërimit të zyrtarëve zgjedhorë

1. KQZ-ja përzgjedh me short zyrtarët zgjedhorë që emëron. Në procedurat e shortit marrin pjesë vetëm zyrtarët zgjedhorë që janë qartësuar për administrim.
2. Në të gjitha rastet kur emërimi është i lidhur me kuotën gjinore, shorti ose përzgjedhja bëhen midis zyrtarëve që i përkasin të njejtës gjini.
3. Zyrtarët zgjedhorë që emërohen në NJAZ duhet të kenë përfunduar arsimin e lartë, të paktën në nivelin “*bachelor*” dhe të kenë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune.
4. Procedura e shortit përcaktohet nga KQZ-ja me akt normativ.”

Amendament KREU II:

Neni

Titulli i Kreut II bëhet:

ZONAT E ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR (ZAZ)
DHE
NJËSITË E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE (NJAZ)

Amendament neni 28:

Neni

Neni 28 ndryshohet si vijon:

“Neni 28

Ngritja e Njësive të Administrimit të Zgjedhjeve

Vendimi për ngritjen e NJAZ-eve merret nga KQZ-ja jo më vonë se 90 ditë para datës së zgjedhjeve. Në rastet e zgjedhjeve të pjesshme ose të parakohshme, NJAZ-i ngrihet jo më vonë se 10 ditë nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve.”

Amendament neni 29:

Neni

Neni 29 ndryshohet si vijon:

“Neni 29

Përbërja e NJAZ-it

1. NJAZ-i përbëhet nga 4 anëtarë dhe 2 sekretarë. Zyrtarët zgjedhorë të NJAZ-it janë individë të kualifikuar në ushtrimin e përgjegjësive të detyrës, të cilët emërohen nga KQZ-ja, me barazi gjinore, me short, midis personave të trainuar si administratorë zgjedhorë në sistemin e trajnimit të KQZ-së.
2. Kryetari dhe zëvendëskryetari i NJAZ-it caktohen nga KQZ-ja në aktin e emërimit, mbi bazën e kriterit profesional, eksperiencës së mëparshme zgjedhore dhe eksperiencës drejtuese administrative. Sekretari i NJAZ-it është përherë me profesionin e juristit.
3. Plotësimi i vendeve të mbetura vakant në NJAZ, bëhet nga KQZ-ja në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën procedurë, sikurse është bërë emërimi i anëtarit që ka krijuar vakancën. Plotësimi i vakancës bëhet brenda 3 ditëve nga konstatimi i saj, kurse në ditën e zgjedhjeve bëhet brenda 3 orëve.
4. Anëtarët dhe sekretarët e NJAZ-it ushtrojnë detyrat në përputhje me përshkrimin individual të detyrës, sikurse specifikohet në kontratën e punës dhe në aktet normative të KQZ-së që rregullojnë veprimtarinë e tyre, si dhe në përputhje me urdhërat dhe udhëzimet që KQZ-ja nxjerr për NJAZ-in përkatës dhe për veprimtarinë e tyre. Anëtarët dhe sekretarët e NJAZ-it përgjigjen individualisht për shkeljet e ligjit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së NJAZ-it ku bëjnë pjesë.
5. Anëtarët dhe sekretarët e NJAZ-it punojnë me kohë të plotë nga e nesërmja e emërimit, deri në lirimin e tyre nga detyra nga ana e KQZ-së. KQZ-ja përcakton orarin e punës së NJAZ-it, në varësi nga kalendari i zgjedhjeve dhe nga rrethi i detyrave që ushtron NJAZ-i. Në ditën e votimit NJAZ-i vepron i ndarë në dy grupe të balancuara (*dy anëtar - një sekretar, me përfaqësim gjinor*) të cilët qendrojnë në detyrë njëri pas tjetrit dhe ndërrohen me njëri tjetrin çdo 8 orë, deri në përfundim të numërimit të votave dhe nxjerrjen e rezultatit në nivel NJAZ-i.
6. Për gjithë periudhën nga data e emërimit deri në datën e lirimin nga detyra, anëtarët dhe sekretarët e NJAZ-it përfitojnë pagë sa paga e vendit të punës, kur janë në marrëdhënie të rregullt pune, por jo më pak se pagën bazë të kategorisë IIIb, sipas kuadrit ligjor për strukturën dhe nivelin e pagave për nëpunësit civilë. Në rast se nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune anëtarët dhe sekretarët e NJAZ-it përfitojnë pagë sa paga bazë e kategorisë IIIb, sipas kuadrit ligjor për strukturën dhe nivelin e pagave për nëpunësit civilë.
7. Punëdhënësit janë të detyruar të lejojnë anëtarët dhe sekretarët e NJAZ-it të ushtrojnë detyrat e ngarkuara për shkak të përzgjedhjes dhe emërimit në NJAZ. Asnjë punëdhënës nuk mund të kushtëzojë vazhdimin e marrëdhënies së punës me refuzimin e pjesëmarrjes në NJAZ, me

detyrimin për të ndjekur porosi apo instruksione nga ana e punëdhënësit, për çështje që lidhen me zbatimin e detyrës në NJAZ, apo me nisjen e procedurave disiplinore për shkak ose lidhur me pjesmarrjen në veprimtarinë e NJAZ-it.¹ Për periudhën e angazhimit në NJAZ punëdhënësit pezullojnë pagën ose shpërblimet e zakonshme të vendit të punës.”²

Amendament neni 30:

Neni

Neni 30 ndryshohet si vijon:

“Neni 30

Papajtueshmëritë me detyrën e zyrtarit zgjedhor të NJAZ-it

1. Zyrtari zgjedhor i NJAZ-it nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar apo sekretar në një NJAZ tjetër dhe as zyrtar i një NJAV-i apo NJAN-i.
2. Zyrtari zgjedhor i NJAZ-it nuk mund të jetë kandidat në zgjedhjet përkatëse dhe as të ketë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë.
3. Zyrtari zgjedhor i NJAZ-it nuk mund të jetë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumëmemërore të një partie apo koalicioni që konkurren në zonë.
4. Zyrtari zgjedhor i NJAZ-it është i detyruar t’i deklarojë KQZ-së papajtueshmërinë sipas këtij neni. Mosdeklarimi i papajtueshmërisë është shkak i vetëmjaftueshëm për vlerësimin “pamjaftueshëm” të tij.”

Amendament neni 31:

Neni

Neni 31 ndryshohet si vijon:

“Neni 31

Kushti i vendbanimit

Zyrtari zgjedhor i NJAZ-it duhet të jetë i regjistruar në listën e zgjedhësve të qarkut, ku shtrin veprimtarinë NJAZ-i;”.

¹ Kush do ishte penaliteti për këtë sjellje?

² Sigurimet shoqërore janë të sqaruara me këtë formulim apo duhet parashikuar diçka më shumë?

Amendament neni 32:

Neni

Neni 32 ndryshohet si vijon:

“Neni 32

Shkarkimi dhe lirimi i zyrtarit zgjedhor të NJAZ-it

1. Anëtari ose sekretari i NJAZ-it shkarkohet nga detyra me vendim të KQZ-së kur:
 - a) gjatë ushtrimit të detyrës kryen veprime ose akte që përbëjnë shkelje të detyrës, sikurse specifikohet në kontratën e punës dhe në aktet normative të KQZ-së që rregullojnë veprimtarinë e NJAZ-it;
 - b) gjatë ushtrimit të detyrës refuzon zbatimin e menjëhershëm të urdhërave të KQZ-së që lidhen me veprimtarinë e NJAZ-it, ose zvarrit apo nënvleftëson zbatimin e urdhërave apo udhëzimeve të KQZ-së, në atë masë sa që rrezikohet mbarëvajtja e punës së NJAZ-it dhe ushtrimi i rregullt i detyrës;
 - c) mungon pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të NJAZ-it, ose në periudhën zgjedhore nuk paraqitet në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht; ose
 - ç) nuk merr pjesë në trajnimet ose nuk kalon testimet e organizuara nga KQZ-ja.
2. Anëtari ose sekretari i NJAZ-it lirohen nga detyra në rast se konstatohet, pas emërimit, papajtueshmëria me detyrën ose mosplotësimi i kushtit të vendbanimit apo kur paraqesin dorëheqjen me shkrim, për shkaqe që nuk lidhen me këtë nen.
3. Në rast se anëtari apo sekretari i NJAZ-it që lirohet ose shkarkohet i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, zëvendësimi bëhet po nga gjinia më pak e përfaqësuar.”

Amendament neni 33:

Neni

Neni 33 ndryshohet si vijon:

“Neni 33

Detyrat e NJAZ-it

NJAZ-i kryen këto detyra:

- a) drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr Njësitë e Administrimit të Votimit (NJAV-et) të ZAZ-së në ushtrimin e detyrave;
- b) Kujdeset për zbatimin uniform të këtij ligji dhe të akteve të KQZ-së në territorin e ZAZ-së;
- c) Verifikon dhe raporton në KQZ problematikat që çenojnë mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, për të cilat vihet në dijeni nga NJAV-et, subjektet zgjedhore, vëzhguesit ose zgjedhësit, kërkon

- vendimmarrjen e KQZ-së për zgjidhjen e tyre dhe kujdeset për parandalimin ose eliminimin e pasojave negative, në përputhje me urdhërat dhe udhëzimet përkatëse të KQZ-së;
- c) regjistron subjektet zgjedhore dhe kandidatët për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore;
 - d) shpërndan dhe mbledh materialet e votimit për çdo QV;
 - dh) kur bëhet numërimi manual i votave, mbikëqyr procesin e numërimit dhe kujdeset për vlerësimin uniform të votave nga të gjitha grupet e numërimit;
 - e) shpall kandidatët fitues për kryetar të bashkisë”.

Amendament neni 34:

Neni

Neni 34 ndryshohet si vijon:

“Neni 34

Detyrat e sekretarëve të NJAZ-it

1. Sekretarët e NJAZ-it, sipas rastit, individualisht ose së bashku, kryejnë këto detyra:
 - a) përgjigjen për dokumentimin, protokollimin, përcjelljen dhe arkivimin e të gjitha procedurave administrative që kryen NJAZ-i, si dhe për ruajtjen dhe mirëadministrimin e materialit zgjedhor që ndodhet në NJAZ;
 - b) hartojnë, mbi bazën e tabelave të rezultatit të grupeve të numërimit, tabelën përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për çdo subjekt zgjedhor në ZAZ dhe ia dërgojnë atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme, në përputhje me nenin 122 të këtij Kodi;
 - c) publikojnë, afishojnë dhe shpërndajnë në territorin e ZAZ-së materialet informative, promovuese, dhe edukative që KQZ-ja ia përcjell për këtë qëllim;
 - ç) afishojnë listat e zgjedhësve të ZAZ-së dhe tabelën përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve;
 - d) me kërkesë të zgjedhësve, lëshojnë vërtetime nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listat përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor;
 - dh) pajisin me kopje dokumentacioni zyrtar subjektet e interesuara, në zbatim të së drejtës për informim dhe rregullave të KQZ-së për informimin e subjekteve dhe vëzhguesve me të dhënat e dokumentacionit zgjedhor;
2. Sekretarët alternojnë njeri tjetrin në kryerjen e detyrave që kërkojnë angazhimin e vetëm njerit prej tyre. Dokumentat, procesverbalet dhe formularët e NJAZ-it nënshkruhen nga sekretari që i përpilon ato.”

Amendament neni 35:

Neni

Neni 35 ndryshohet si vijon:

“Neni 35

Mbledhjet dhe vendimet e NJAZ-it

1. Mbledhjet e NJAZ-it janë publike.
2. Për vlefshmërinë e mbledhjes kërkohet prania e shumicës së zyrtarëve zgjedhorë të NJAZ-it. Sekretarët kanë të drejtën e votës dhe llogariten në kuorum. Vendimet e NJAZ-it merren me shumicën e votave.
3. Vendimet e NJAZ-it nënshkruhen nga të gjithë zyrtarët zgjedhorë që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej tyre, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën “pro” ose “kundër”, si dhe arsyetimin përkatës.
4. Në rast se NJAZ-i nuk krijon dot shumicën vendimmarrëse atëherë sekretari ia dërgon çështjen për shqyrtim KQZ-së brenda 24 orëve. Urdhëri i KQZ-së është i detyrueshëm për zbatim nga NJAZ-i.”

Amendament Kreu III:

Neni

Titulli i Kreut III bëhet:

NJËSIA E ADMINISTRIMIT TË VOTIMIT (NJAV)

Amendament neni 36:

Neni

Neni 36 ndryshohet si vijon:

“Neni 36

Njësia e Administrimit të Votimit

1. NJAV-i është struktura e administratës zgjedhore e ngarkuar me kryerjen e procedurave të votimit në qendrën e votimit. NJAV-i formohet, me përfaqësim të garantuar gjinor, nga tri zyrtarë zgjedhorë: zyrtari mbikëqyrës, zyrtari i qartësimit të votuesve, zyrtari i procedurave të votimit.
2. NJAV-i ka për detyrë të kryejë identifikimin e votuesve përpara votimit, të udhëzojë dhe drejtojë votuesit për ushtrimin individualisht, në liri dhe fshehtësi të së drejtës së votës, të kujdeset për zhvillimin dhe mbylljen e rregullt të procesit, si dhe të ruajë dhe administrojë nën përgjegjësinë e vet materialin zgjedhor.

3. Zyrtarët zgjedhorë të NJAV-it janë individë të kualifikuar në ushtrimin e përgjegjësive të detyrës, të cilët emërohen nga KQZ-ja, me short, midis personave të trainuar si administratorë zgjedhorë në sistemin e trajnimit të KQZ-së, kur administrimi i votimit kryhet nga administrata e KQZ-së, ose që kontraktohen nga operatori i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informatike, kur administrimi i votimit kryhet nga ky i fundit.
4. Pavarësisht nga mënyra e formimit, funksionet e zyrtarëve zgjedhorë të NJAV-it ushtrohen individualisht dhe me përgjegjësi ligjore individuale, sikurse specifikohen në përshkrimin e detyrës, në kontratën e punës dhe në aktin normativ të KQZ-së që përcakton procedurat e votimit. Zyrtarët zgjedhorë të NJAV-it janë të detyruar të zbatojnë, sipas parimit të hierarkisë administrative, edhe urdhërat dhe udhëzimet që KQZ-ja ose NJAZ-i përkatës nxjerr për veprimtarinë e tyre.
5. Kur identifikimi i votuesve dhe votimi bëhen me letër (identifikimi dhe votimi manualisht³) zyrtari i qartësisimit të votuesve kryen verifikimin e të dhënave të identitetit të zgjedhësit që paraqitet në qendrën e votimit, mbi bazën e dokumentit të identifikimit dhe të dhënave të votuesit në listën e zgjedhësve, dhe qartësimin e zgjedhësit për votim⁴, zyrtari i procedurave të votimit administron fletët e votimit dhe ua dorëzon ato votuesve të identifikuar dhe të qartësuar për votim, kurse zyrtari mbikëqyrës mbikëqyr dhe kujdeset për rregullin në qendrën e votimit, si dhe garanton fshehtësinë e votimit për secilin votues.
6. Kur identifikimi i votuesve dhe votimi bëhen me dhe nëpërmjet sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit (identifikimi dhe votimi elektronik⁵) zyrtari i qartësisimit të votuesve kryen verifikimin e të dhënave të identitetit të zgjedhësit që paraqitet në qendrën e votimit, mbi bazën leximit të të dhënave biometrike dhe përqasjes së tyre me bazën elektronike të të dhënave për listën e zgjedhësve të qendrës së votimit, dhe qartësimin e zgjedhësit për votim, zyrtari i procedurave të votimit administron sistemin apo pajisjet e votimit elektronik, udhëzon dhe asiston zgjedhësit e identifikuar dhe të qartësuar për votim në përdorimin e pajisjeve, garanton fshehtësinë e votimit për secilin votues, dhe siguron paprekshmërinë e pajisjeve nga ndërhyrjet e paligjshme, kurse zyrtari mbikëqyrës mbikëqyr dhe kujdeset për rregullin në qendrën e votimit.

³ Në nenin e përkufizimeve duhet përkufizuar koncepti “**identifikimi manualisht**”: identifikimi nëpërmjet verifikimit të të dhënave nga dokumenti i identifikimit me të dhënat nga kopja e listës së zgjedhësve që administrohet nga NJAV-i, si dhe “**Votim manualisht**”: votimi i materializuar në letër, në formën e fletës së votimit, sipas formatit të miratuar nga KQZ-ja.

⁴ Në nenin e përkufizimeve duhet përkufizuar koncepti “**Qartësimi për votim**”: procedura e verifikimit të të dhënave identifikuese dhe personale të zgjedhësve nga strukturat e ngarkuara ligjërisht me këtë detyrë, përpara se zgjedhësi të lejohet të votojë ose përpara se t’i vihet në dispozicion dokumentacioni i votimit, sipas procedurës korresponduese për votimin që po kryen.

⁵ Në nenin e përkufizimeve duhet përkufizuar koncepti “**identifikimi elektronik**”: identifikimi nëpërmjet verifikimit të të dhënave të identitetit të votuesve mbi bazën leximit të të dhënave biometrike dhe përqasjes së tyre me bazën elektronike të të dhënave për listën e zgjedhësve të qendrës së votimit, si dhe “**Votim elektronik**”: votimi i materializuar si informacion, i regjistruar dhe ruajtur në pajisjet apo sistemet e teknologjisë së informacionit, pavarësisht nëse është dubluar ose jo në letër.

7. Zyrtari mbikëqyrës kryen edhe detyrën e sekretarit të NJAV-it. Ai është përgjegjës për dokumentacionin shkresor të NJAV-it.
8. Zyrtarët zgjedhorë të NJAV-it punojnë me kohë të plotë nga e nesërmja e emërimit, deri në lirim të tyre nga detyra nga ana e KQZ-së. KQZ-ja përcakton orarin e punës së NJAV-it, në varësi nga kalendari i zgjedhjeve dhe nga rrethi i detyrave që ushtron NJAV-i.
9. Për gjithë periudhën nga data e emërimit deri në datën e lirimit nga detyra, zyrtarët zgjedhorë të NJAV-it përfitojnë, për ditë angazhimi në NJAV, pagë sa paga e vendit të punës për ditë pune, kur janë në marrëdhënie të rregullt pune, por jo më pak se 1/2 e pagës bazë të kategorisë IIIb, sipas kuadrit ligjor për strukturën dhe nivelin e pagave për nëpunësit civilë.
10. Punëdhënësit janë të detyruar të lejojnë zyrtarët zgjedhorë të NJAV-it të ushtrojnë detyrat e ngarkuara për shkak të përzgjedhjes dhe emërimit në NJAV. Asnjë punëdhënës nuk mund të kushtëzojë vazhdimin e marrëdhënies së punës me refuzimin e pjesëmarrjes në NJAV, me detyrimin për të ndjekur porosi apo instruksione nga ana e punëdhënësit, për çështje që lidhen me zbatimin e detyrës në NJAV, apo me nisjen e procedurave disiplinore për shkak ose lidhur me pjesëmarrjen në veprimtarinë e NJAV-it. Për periudhën e angazhimit në NJAV punëdhënësit pezullojnë pagën ose shpërblimet e zakonshme të vendit të punës.
11. Rregullat për përzgjedhjen e zyrtarëve zgjedhorë të NJAV-it, rregullat për përfaqësimin gjinor, rrethi i detyrave të secilit zyrtar, rregullat dhe procedurat e veprimit dhe dokumentimit të procesit të votimit, si dhe marrëdhëniet e mbikëqyrjes, drejtimit, asistencës dhe raportimit kundrejt institucioneve të tjera, gjatë ushtrimit të detyrës nga NJAV-i, përcaktohen në mënyrë të detajuar me aktet normative të KQZ-së, për të dyja llojet e identifikimit dhe votimit.”

Amendament neni 37:

Neni

Neni 37 ndryshohet si vijon:

“Neni 37

Papajtueshmëritë me detyrën e zyrtarit zgjedhor të NJAV-it

1. Zyrtari zgjedhor i NJAV-it nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar apo sekretar në një NJAZ dhe as zyrtar i një NJAV-i tjetër apo i një NJAN-i.
2. Zyrtari zgjedhor i NJAV-it nuk mund të jetë kandidat në zgjedhjet përkatëse dhe as të ketë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë.
3. Zyrtari zgjedhor i NJAV-it nuk mund të jetë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumëmemërore të një partie apo koalicioni që konkurren në zonë.

4. Zyrtari zgjedhor i NJAV-it është i detyruar t'i deklarojë NJAZ-it papajtueshmërinë sipas këtij neni. Mosdeklarimi i papajtueshmërisë është shkak i vetëmjaftueshëm për vlerësimin “pamjaftueshëm” të tij.”

Amendament neni 38:

Neni

Neni 38 ndryshohet si vijon:

“Neni 38

Kushti i vendbanimit

Zyrtari zgjedhor i NJAV-it duhet të jetë i regjistruar në listën e zgjedhësve të qarkut, ku shtrin veprimtarinë NJAV-i;”.

Amendament neni 39:

Neni

Neni 39 ndryshohet si vijon:

“Neni 39

Shkarkimi dhe lirimi i zyrtarit zgjedhor të NJAV-it

1. Zyrtarët zgjedhorë të NJAV-it shkarkohet nga detyra me vendim të KQZ-së kur:
 - a) Gjatë ushtrimit të detyrës kryejnë veprime ose akte që përbëjnë shkelje të detyrës, sikurse specifikohet në kontratën e punës dhe në aktet normative të KQZ-së që rregullojnë veprimtarinë e NJAV-it;
 - b) Gjatë ushtrimit të detyrës refuzojnë zbatimin e menjëhershëm të urdhërave të KQZ-së, që i përcillen drejtpërdrejt ose nëpërmjet NJAZ-it, ose zvarrisin apo nënvleftësojnë zbatimin e urdhërave apo udhëzimeve të KQZ-së, në atë masë sa që rrezikohet mbarëvajtja e punës së NJAV-it dhe ushtrimi i rregullt i detyrës;
 - c) nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se se 2 ditë rresht; ose
 - ç) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.
2. Zyrtari zgjedhor i NJAV-it lirohet nga detyra në rast se konstatohet, pas emërimit, papajtueshmëria me detyrën ose mosplotësimi i kushtit të vendbanimit.
3. Në rast se zyrtari zgjedhor i NJAV-it që lirohet ose shkarkohet i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, zëvendësimi bëhet po nga gjinia më pak e përfaqësuar.”

Amendament nenet 40 dhe 41:

Neni

Nenet 40 dhe 41 shfuqizohen.

Amendament neni 42:

Neni

Neni 42 ndryshohet si vijon:

“Neni 42

Mbledhjet dhe vendimet e NJAV-it

1. Veprimtaria e NJAV-it është publike.
2. NJAV-i merr vendim me shumicë votash për çeljen dhe mbylljen e votimit, për pezullimin dhe rifillimin e votimit, si dhe për thirrjen e forcave të policisë në mjediset e qendrës së votimit në rastet e prishjes së rendit gjatë votimit.
3. Të gjitha vendimet e NJAV-it pasqyrohen të arsyetuara, në librin e protokollit të NJAV-it dhe nënshkruhet nga secili zyrtar zgjedhor.
4. Të gjitha vendimet e tjera që kanë lidhje me procesin e votimit merren individualisht nga zyrtarët zgjedhorë të NJAV-it, në përputhje me përgjegjësitë e tyre.

Amendament shtesë:

Neni (për t'u caktuar)

Njësia e Administrimit të Numërimit (NJAN-i)

1. Njësia e Administrimit të Numërimit është struktura e administratës zgjedhore e ngarkuar me kryerjen e procedurave për numërimin e votave, kur numërimi kryhet manualisht.
2. NJAN-i formohet, me përfaqësim të garantuar gjinor, nga dy zyrtarë zgjedhorë.
3. Zyrtarët zgjedhorë të NJAN-it janë individë të kualifikuar në ushtrimin e përgjegjësive të detyrës, të cilët emërohen nga KQZ-ja, me short, midis personave të trainuar si administratorë zgjedhorë në sistemin e trainimit të KQZ-së.
4. NJAN-i bën vlerësimin e votave, numerimin e tyre për çdo subjekt zgjedhor dhe tabulimin e rezultatit të QV-së. Kompetenca për vlerësimin e votave, numerimin e tyre për çdo subjekt zgjedhor dhe tabulimin e rezultatit të QV-së është kompetencë ekskluzive e NJAN-it. Vendimmarrja e NJAN-it në ushtrim të kësaj kompetence mund të ndryshohet vetëm sipas procedurës ankimore të këtij ligji.
5. Funksionet e zyrtarëve zgjedhorë të NJAN-it ushtrohen individualisht dhe me përgjegjësi ligjore individuale, sikurse specifikohen në përshkrimin e detyrës, në kontratën e punës dhe në aktin normativ të KQZ-së që përcakton procedurat e numërimit dhe vlerësimit të votave. Shkelja e detyrimit për vlerësimin uniform të votave nga zyrtarët zgjedhorë të NJAN-it i ngarkon ata me përgjegjësi penale.

6. Zyrtarët zgjedhorë të NJAN-it janë të detyruar të zbatojnë, sipas parimit të hierarkisë administrative, edhe urdhërat dhe udhëzimet organizative që KQZ-ja ose NJAZ-i përkatës nxjerr për veprimtarinë e tyre.
7. Zyrtarët zgjedhorë të NJAN-it punojnë me kohë të plotë nga e nesërmja e emërimit, deri në lirimin e tyre nga detyra nga ana e KQZ-së. KQZ-ja përcakton orarin e punës së NJAN-it, në varësi nga kalendari i zgjedhjeve dhe nga rrethi i detyrave që ushtron NJAN-i.
8. Për gjithë periudhën nga data e emërimit deri në datën e lirimit nga detyra, zyrtarët zgjedhorë të NJAN-it përfitojnë, për ditë angazhimi në NJAN, pagë sa paga e vendit të punës për ditë pune, kur janë në marrëdhënie të rregullt pune, por jo më pak se 1/2 e pagës bazë të kategorisë IIIb, sipas kuadrit ligjor për strukturën dhe nivelin e pagave për nëpunësit civilë.
9. Punëdhënësit janë të detyruar të lejojnë zyrtarët zgjedhorë të NJAN-it të ushtrorjnë detyrat e ngarkuara për shkak të përzgjedhjes dhe emërimit në NJAN. Asnjë punëdhënës nuk mund të kushtëzojë vazhdimin e marrëdhënies së punës me refuzimin e pjesëmarrjes në NJAN, me detyrimin për të ndjekur porosi apo instruksione nga ana e punëdhënësit, për çështje që lidhen me zbatimin e detyrës në NJAN, apo me nisjen e procedurave disiplinore për shkak ose lidhur me pjesëmarrjen në veprimtarinë e NJAN-it. Për periudhën e angazhimit në NJAN punëdhënësit pezullojnë pagën ose shpërblimet e zakonshme të vendit të punës.”

Amendamente pasuese në pjesën III

“Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve”

Amendament neni 44

Neni

Në nenin 44 bëhen ndryshimet si vijon:

- shkronja “d” shfuqizohet.
- shkronja “dh” ndryshohet si vijon:

“dh) të regjistrohet zgjedhës në listën e vetëm një zone qendre votimi ose në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit;”

Amendament neni 46

Neni

Në nenin 46 shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje:

“3. Zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë vendit, sipas Regjistrisë Kombëtare të Gjendjes Civile, përfshihen në një zonë unike qendre votimi që i bashkangjitet Qarkut Tiranë, pavarësisht nga numri i tyre, dhe regjistrohen me kod unik vendbanimi. Lista e zgjedhësve për këtë zonë qendre votimi, e emërtuar “lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit”, hartohet vetëm me të dhënat e zgjedhësve që deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas paragrafëve 3 dhe 5 të nenit 21/2 të këtij Kodi.

Amendamente pasuese në pjesën XIV
“Dispozita të fundit dhe kalimtare”

Amendament neni 179:

Neni

Neni 179 shfuqizohet.

Amendament neni 179/1:

Neni

Neni 179/1 shfuqizohet.

**AMENDAMENTE PËR LIGJIN NR. 152/2013 “PËR NËPUNËSIN CIVIL”, TË
NDRYSHUAR**

Amendament 1:

Neni

Pas shkronjës “b” të paragrafit 1 të nenit 9 shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) programit të formimit si zyrtar zgjedhor, në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe sipas kurikulës që ofron struktura e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e cila merret me trainimin e zyrtarëve zgjedhorë.”

Amendament 2:

Neni

Pas shkronjës “e” të nenit 21 shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“e) të jetë i kualifikuar paraprakisht si zyrtar zgjedhor dhe, nëse ka marrë pjesë në administrimin e proceseve zgjedhore, të jetë vlerësuar pozitivisht në ushtrimin e detyrave si zyrtar zgjedhor.”

Amendament 3:

Neni

Në nenin 37 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

4. Ushtrimi i të drejtave politike nuk mund të bierë ndesh dhe as të ndikojë negativisht në ushtrimin e detyrës në përputhje me parimin e paanësisë politike.
5. Nëpunësve civilë që shërbejnë si zyrtarë zgjedhorë u pezullohen të drejtat politike për gjithë kohëzgjatjen e shërbimit si zyrtarë zgjedhorë, me përjashtim të së drejtës për të zgjedhur.

Amendament 4:

Neni

Në nenin 42 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

4. Nëpunësit civilë të të gjitha niveleve kanë detyrimin të shërbejnë si zyrtarë zgjedhorë, sa herë që kjo gjë u kërkohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për administrimin e zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë. Nëpunësit civilë që shërbejnë si zyrtarë zgjedhorë pezullohen nga detyra, për gjithë kohezgjatjen e shërbimit si zyrtarë zgjedhorë.
5. Refuzimi pa shkak të ligjshëm për të shërbyer si zyrtar zgjedhor, braktisja e detyrës së caktuar, cënimi i parimit të paanësisë politike gjatë kohëzgjatjes së shërbimit si zyrtar zgjedhor ose

moszbatimi apo shkelja, me pasoja të rënda, e rregullave dhe detyrimeve gjatë ushtrimit të detyrës së zyrtar zgjedhor në një proces zgjedhor, formojnë shkak të ligjshëm për largimin e nëpunësit nga shërbimi civil.

Amendament 5:

Neni

Në pikën 2, të nenit 57 shtohet shkronja “dh”, me përmbajtjen si vijon:

“dh. Refuzimi pa shkak të ligjshëm për të shërbyer si zyrtar zgjedhor, braktisja e detyrës së caktuar, cënimi i parimit të paanësisë politike gjatë kohëzgjatjes së shërbimit si zyrtar zgjedhor ose moszbatimi apo shkelja, me pasoja të rënda, e rregullave dhe detyrimeve gjatë ushtrimit të detyrës së zyrtarit zgjedhor në një proces zgjedhor”.

Amendament 6:

Neni

Në nenin 59 bëhen këto ndryshime:

a) Pas shkronjës “c” të paragrafit 4 shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) me propozim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkelje të kryera në ushtrimin e detyrave si zyrtar zgjedhor.”

b) Në fund të paragrafit 7 shtohet fjalitë me këtë përmbajtje:

“Nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga ana e komisionit disiplinor faktet juridike dhe rrethanat, ku është mbështetur propozimi i KQZ-së për masë disiplinore, sipas shkronjës “ç” të paragrafit 4 të këtij neni. Akti i KQZ-së që përmban propozimin është për komisionin disiplinor prova zyrtare e shkeljes.”